



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 1001 (31010-00297-83-2016)
Dt. Rregj. 23.03.2016

Nr. Vendimi 655(573)
Dt. Vendimi 11.10.2016

V E N D I M
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me datë 11.10.2016, ora 10.30 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.Rregj.Them. 1001 (31010-00297-83-2016) datë 23.03.2016 që i përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: Subjekti tatim pagues "Rudina Mataj", NIPT: L38512502N, adresa: Rudina Mataj, Lagjja "Beselidhja", Rruga "Shtraus", lokali "Ambasador", Lezhe.

TE PADITUR: 1.Drejtoria Rajonale Tatimeve Lezhe (në mungesë).
2.Drejtoria Pergjithshme e Tatimeve Tirane(në mungesë)

me pjesmarrie të: Avokatura e shtetit (në mungesë),

OBJEKTI: Shfuqizimin akteve administrative "Njoftim vleresimi per detyrimet" nr. 11983/18 prot, dt. 23.11.2015 nxjerre nga D.R Tatimeve Lezhë dhe vendimit nr. 41779/ 1 prot, dt. 18.02.2016 DPT Tiranë.

BAZA LIGJORE: Ligji 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative". Ligji 9920, dt. 19.5.2008 "Per Procedurat tatimore" ne Republikën e Shqiperise. Nenet 116, 118 e vijues K.P.Administrative.

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura dhe pasi dëgjoi palën paditëse që kërkoi përfundimisht pranimin e kërkesë padisë sipas objektit të saj, në mungesë të palëve të paditura, por që në prapsime me shkrim kërkojnë rrezimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligjë dhe prova, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se;

Paditësi, subjekti tatim pagues "Rudina Mataj", i është drejtuar gjykatës administrative shkallë e Parë Shkodër me kërkesë padi kundër anës së paditur: Drejtoria Rajonale Tatimeve Lezhë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, me objekt; Shfuqizimin e akteve administrative; "Njoftim vleresimi per detyrimet" nr. 1983/18 prot, dt.23.11.2015, nxjerre nga DRTatimeve Lezhe dhe vendimit nr.41779/1prot, dt. 18.02.2016 të DPT Tiranë.

Rrethanat e çështjes;

Paditësia Rudina Mataj ushtron aktivitet tregtare, me drejtim Bare Bufe, ne lagjen Beselidhja, qyteti Lezhe, rregjistruar ne QKR me numer nipti L38512502N. Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe, me date 09.10.2015, ka ushtruar kontroll ne subjektin Rudina Mataj ku dhe eshte mbajtur akt-kostatimi me nr.0609730, 0609731, 0609732, 0609733 date 09.10.2015. Nga verifikimi i akt-kostatimeve te mbajtura ne subjektin e lartepemendur, rezultoi sipas te cileve:

Subjekti Rudina Mataj ushtron aktivitetin Bare-Hotel, ne nje godine tre kateshe + papafingo.

1-Ne katin e pare eshte ne funksion Bar bufe.

2-Ne katin e dyte u konstatua 5 dhoma te mobiluara dhe nuk ishin te zena ne momentin e kontrollit.

Ne katin e trete, u konstatuan 4 dhoma dhe nje magazine dhe dhomat nuk ishin te zena ne momentin e kontrollit. Ne papafingo u konstatua nje shtepi banimi te cilin subjekti deklaroi se eshte shtepi e tij.

Nga verifikimi i bere ne ekstraktin e QKR-së rezultoi qe subjekti ka te deklaruar vetem Bar Kafe dhe nuk ka perditesuar te dhenat per hotelin. Per kete propozojme ndryshimin e pergjegjesise tatimore.

Per kete subjekt, pasi eshte subjekt i tatimit te thjeshtuar te fitimit dhe kalimin ne TVSH nisur nga lloji i aktivitetit, ne zbatim te ligjit nr7928, dt.27.4.1995 "Per tatimin mbi vleren e shtuar" i ndryshuar, Subjekti ka te instaluar paisjen fiskale me nr AE02012238.

3-Ne momentin e kontrollit u gjet nje tavoline me dy kliente, e cila nuk ishte sherbyer me kupon tatimore. Paisja fiskale qe sublekti ka te instaluar nuk ishte ne gjendje pune ne momentin e kontrollit, eshte e fikur. Subjekti pretendon se ajo nuk ishte e ndezur ne fillim te kontrollit pasi kishte mungese te energjise elektrike.

4-Ne momentin e kontrollit u gjenden ne pune znj. Rudina Mataj me nr Ident: 13512502N, znj: Adelina Kameri me nr Ident.J35125033L, znj Alketa Vata me nr ident.175609091V. Punonjesja Adelina Kameri nuk rezultoi e deklaruar ne organin tatimore.

5-Subjekti ka bere afishimin e çmimeve dhe i tabelës ku tregon detyrimin per terheqjen e kuponit tatimore nga bleresi.

6- Nga inventarizimi i mallrave ne Bare Bufe u konstatuan nje sasi e ketyre mallrave pa dokumenta tatimore, te cilat u konfiskuan me proces verbal".

Mbi bazen e ketij akt konstatimi Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhe me shkresen Nr 11983/18, dt.23.11.2015 "Njoftim vleresimi per detyrimet në bazë të të cilit ngarkon kete subjekt me detyrimet e meposhtme:

Gjobe me vlere 50 000 lek per mosdeklarim punonjesi.

Gjobe ne vleren 40 000 lek per mosmirembajtje kase.

Gjobe ne vleren 50 000 per mosleshim kuponi.

Gjobe ne vleren 10 000 lek per mosperditesim te dhenash.

Ndaj ketij akti është ushtruar ankim ne DPTatimeve Tirane e cila me vendimin nr41779/1prot dt. 18.02.2016, ka vendosur lenien ne fuqi të aktit "njoftim vlerësimi per detyrimet" nr. 11983/18 prot, dt. 23.11.2015, të nxjerre nga D.R Tatimeve Lezhë .

Ne gjykim paditësi parashtroi se;

-Gjobën për mosdeklarim punonjësi e kundërshtoj për faktin se punonjësja Adelina Kameri për shkak të natyrës së punës si kamarjere ishte e domosdoshme marrja në provë dhe për koevidence kjo ka qënë dita e parë dhe e vetme pasi te nesërmen e kësaj dite une e kam deklaruar në institucionin tatimor, si e punësuar.

-Gjobën për mosmirëmbajtje kase për aresyen se ajo ka qene në gjendje pune por në momentin e kontrollit ajo ka qënë e fikur dhe kjo për mungesë të energjisë elektrike.

-Gjobën për moslëshim kuponi tatimor për faktin se siç theksova edhe mësipër kasa fiskale ishte e fikur për mungesë të energjisë elektrike.

Ana e paditur prapson me shkrim;

Drejtorja Rajonale ka bërë vlerësimin e aktit të kostatimit, ku subjekti rezultoi në shkelje të ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe udhezimit nr.24 date 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, **nenit 112,119,122 germa "b" dhe "g"**.

Veprimet e kryera nga administrata tatimore janë konforme ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe denimi është i drejte.

Inspektoret e Drejtorisë Rajonale Lezhe, kanë mbajtur aktin e konstatimit në vendin e kundërvajtjes, duke përfshirë përveç emrit edhe të dhenat e tjera, gjithashtu inspektoret kanë evidentuar faktin që tatimpaguesi ka firmosur aktin e konstatimit, duke zbatuar me korrektesë procedurat ligjore. Kërkojme rrëzimin e kerkese padise si të pa bazuar në ligjë dhe në prova.

Gjykata vlereson se;

Në bazë të ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 80 pika 5 si dhe udhezimit të Ministrisë së Financave nr.24 date 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", kreu X "Kontrolli Tatimor, pika 80.3 germa C. Verifikimet në vend.

KONTROLLI TATIMOR

Neni 80 I ligjit 9920/2008

Kontrolli tatimor .

1. Administrata tatimore kontrollojnë deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta.
2. Kontrolli i tatimpaguesit bazohet në deklaratat e dhëna nga tatimpaguesi, si dhe në librat, regjistrimet e informacionin e dhënë nga palët e treta ose në përputhje me mënyrat alternative të vlerësimit, parashikuar në nenin 72 të këtij ligji.
3. Administrata tatimore kontrollojnë saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe çdo dokument tjetër me rëndësi për përcaktimin e detyrimit tatimor.
4. Zgjedhja e tatimpaguesve, që kontrollohen, bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut, të kryer nga administrata tatimore, për të identifikuar tatimpaguesin, i cili ka më shumë rrezik për ta shkelur legjislacionin tatimor.
5. Kontrolli, që kryhet nga administrata tatimore qendrore, urdhërohet nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve apo drejtuesit e njësive të ngjashme me të.

Kontrollet, që kryhen nga administrata tatimore vendore, urdhërohen nga titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore.

6. Procedurat për kryerjen e kontrolleve tatimore dhe llojet e kontrolleve tatimore miratohen nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Neni 81

Njoftimi i kontrollit tatimor

Administrata tatimore I dërgon tatimpaguesit njoftimin I cili përcakton tatimpaguesin si subjekt të kontrollit tatimor identifikimin e organit, që kryen kontrollin tatimor;

- b) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik, subjekt kontrolli;
- c) numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
- ç) datën e lëshimit;
- d) bazën ligjore për kontrollin;
- dh) llojet e tatimit, objekt të kontrollit;
- e) periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor;
- ë) një përshkrim të të drejtave dhe të detyrave të tatimpaguesit gjatë kontrollit tatimor, përfshirë të drejtën e ankimit të vlerësimit, që bëhet në bazë të kontrollit tatimor;
- f) datën dhe orën kur fillon kontrolli tatimor;
- g) vendin e kontrollit tatimor;
- gj) nënshkrimin e titullarit të zyrës;
- h) një kërkesë për vënien në dispozicion të administratës tatimore të informacionit specifik për kontrollin tatimor.

Ne udhezim te Ministrise se Financave nr.24 date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", kreu X "Kontrolli Tatimor, pika 80.3 germa C. Verifikimet ne vend.

KONTROLI TATIMOR Sipas udhezimit nr.24 date 02.09.2008 "

Kontrolli tatimor 80.1.

1 Objektivi i kontrollit tatimor është sigurimi i plotësisht të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, nëpërmjet zbulimit dhe parandalimit të shmangieve tatimore dhe evazionit fiskal.

80.1.2 Përpara se te procedohet konkretisht nëpërmjet një kontroll tatimor tek personi i tatueshëm, drejtoria rajonale e tatimeve është e detyruar ti dërgojë paraprakisht atij njoftimin për kontroll. Përmbajtja e njoftimit për kontroll është siç përcaktohet ne nenin 81 te ligjit.

80.2 Kontrolli tatimor i veprimtarisë ekonomike e tregtare te personit te tatueshëm bazohet ne deklaratat tatimore te tij, ne dokumentet, ne librat dhe regjistrimet e mbajtura nga ai, si dhe ne te dhënat e siguruara nga palët e treta qe kane hyre ne marrëdhënie me personin e kontrolluar apo nga çdo burim tjetër te mundshëm informacioni. Kontrolli konsiston ne verifikimin ne vend te kontabilitetit dhe te dokumentacionit te mbajtur nga tatimpaguesi (i çfarëdo forme juridike qofte ai), për tu siguruar mbi saktësinë e deklaratave te paraqitura. Nëse kontabiliteti i tatimpaguesit është i kompjuterizuar, kontrollori mund te thërrasë persona te specializuar ne kontrollin informativ. Ne kete rast, personi i tatueshëm informohet me shkrim për emrat dhe cilësitë e këtyre te fundit. Kur gjate ushtrimit te kontrollit tatimor tek personi i tatueshëm, konstatohen rrethanat e përcaktuara ne nenin 71 të ligjit, drejtoria rajonale e tatimeve mund të procedojë me mënyrat alternative të vlerësimit tatimor

80.3 Kontrollet tatimore janë:

a) Kontrolli tatimor i plote ne vend. Këto kontrolle janë gjithëpërfshirëse dhe ndërmëren për te kontrolluar te gjitha aspektet e biznesit te personit te tatueshëm për te gjitha periudhat kohore qe nga kontrolli i plote i fundit dhe te gjithë llojet e tatimeve. Këto kontrolle kryhen bazuar në analizën e riskut.

b) Vizitat fiskale. Këto janë kontrolle te shkurtra te kryera gjate një periudhe te shkurtër kohore për te verifikuar saktësinë e deklaratave dhe pagesave, si rregull vetëm për një periudhe te caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi. Në rastet kur nga këto vizita fiskale konstatohen probleme serioze dhe dyshime të bazuara për fshehje tatimi, kontrollori propozon kryerjen e një kontrolli te plote ne vend.

c) Verifikimet ne vend. Këto verifikime te shkurtra synojnë zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshëm (identifikimin e personave te pa rregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj. Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e ditës, te lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë se kontrollit për verifikime ne vend. Procedurat teknike të detajuara për kryerjen e një kontrolli tatimor përcaktohen ne manualin e kontrollit tatimor.

80.5 Kontrollat, që kryhen nga administrata tatimore qendrore, urdhërohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve, duke u bazuar në planet e kontrollit dhe rezultatet e analizës së riskut.

Referuar rrethanave te faktit rezulton se kontrolli tatimore i bere tek subjekti Rudina Mataj, nuk eshte bere sipas kerkesave te nenit 80 dhe 80.5 i udhezimit nr 24 te siper cituar, per faktin se nje kontroll tatimore duhet te filloje me nje urdher pune, ne te cilin te pershkruhen te dhenat sipas nenit 81, duke percaktuar subjektin qe kontrollohet, kohen, oren e kontrollit, cfare duhet te kontrollohet dhe nga kush do realizohet ky kontroll tatimore.

Ne rastin ne gjykim rezulton qe jo vetem nuk ka patur urdher pune per kontroll, se ky kontroll nga inspektoret eshte realizuar nepermjet njoftimit me telefon, ne kundërshtim flagrant me ligjin 9920/2008 (fakt i pershkruar dhe ne akt konstatimet e dt 09.10.2015).

Per pasoje gjykata konstaton se cdo vendim i mevonshem i administrates tatimore i marre ne kundërshtim me ligjin 9920/2008, eshte absolutisht i pa vlefshëm , pasi eshte pasoj e nje kontrolli teresisht ne shkelje te ligjit dhe sjelle vetem nulitet si dhe vete veprimet e administrates.

Për pasojë gjykata arrin ne konkluzionin se "njoftim vlerësimi tatimor" nr. 1983/18 prot, dt.23.11.2015, nxjerre nga DRTatimeve Lezhe dhe vendimit nr. 41779/1 prot, dt.18.02. 2016 DPT –Tiranë janë rrjedhojë e paligjshmerisë së vetë veprimeve të administratës tatimore, për arsye që më sipër gjykata analizoi.

Nga sa mësipër analizoi gjykata e gjen kërkimin e paditësit të mbështetur në prova dhe ligjë dhe vendose pranimin e kërkesë padisë dhe duke qënë se vlera e aktit që kundërshtohet është me vogël se njëzet fishi i pagës minimale në shkallë vendi, konform nenit 45 pika b të ligjit 49/2012,ky vendim është i formës së prerë, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40,41,42 dhe 45 pika "b" të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" nenit 126 306, 310 të K.pr. Civile si dhe të ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimore"

VENDOSI

-Pranimin e kërkesë padisë.

-Shfuqizimin e akteve administrative "njoftim vlerësim tatimore" nr 1983/18 prot, dt.23.11.2015, nxjerrë nga DRTatimeve Lezhë dhe të vendimit nr.41779/1 prot, dt. 18.02.2016, të Drejtorisë së Apelitit tatimor pranë Drejtorisë se Përgjithshme Tatimeve Tiranë.

-Ky vendim është i formës së prerë, përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet menjëherë.

-Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë.

Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

-Shkoder me date 11.10.2016

SEKRETARE SEANCE
Borana LITI



GJYQTARE
Valbona DURRAJ

